

UDHËZIM
Nr.6, datë 21.4.2005

PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE CAKTIMIT TË VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1 germa b, nenit 94 dhe 95 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat, që duhet të ndiqen nga organet e qeverisjes vendore dhe KZZ-të, gjatë procesit të ngritjes së qendrave të votimit.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Zona e qendrës së votimit është një zonë gjeografike, brenda territorit të një zone zgjedhore, të përcaktuar në përputhje me Kodin Zgjedhor.
2. Qendër votimi është mjedisi i caktuar nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për zhvillimin e procesit të votimit.
3. Qendrat e votimit krijohen në:
 - a) mjedise publike, ku përfshihen: shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetsore, qendra kulturore, qendra sportive etj;
 - b) mjedise private në pronësi të personave fizikë ose juridikë me autorizim të KQZ-së;
 - c) institucione të posaçme, ku përfshihen: spitalet, dhomat e paraburgimit, qendra riedukimi, vende të vuajtjes së dënimit e të tjera të tilla;
 - d) ndalohet ngritja e qendrave të votimit jashtë mjediseve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 3
Vendndodhja e qendrës së votimit

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim, cakton vendndodhjen e qendrës së votimit.
2. Në caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore duhet të mbajë parasysh, për aq sa është e mundur, që adresa e qendrës së votimit të jetë e njëjtë me atë të përdorur në zgjedhjet pararendëse.
3. Kur në territorin e zonës së qendrës së votimit nuk ka mjedise publike, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore i propozon KQZ-së, ngritjen e qendrës së votimit në një objekt privat, duke shpjeguar arsyet përkatëse.
4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se data 15 maj 2005, dërgon në KQZ-në dhe KZZ-në përkatëse një kopje të vendimit për numrin total të QV-ve, vendndodhjen e çdo qendre votimi, së bashku me numrin përkatës të zgjedhësve në listën paraprake.
5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në 10 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve, kur ka forcë madhore. Në këto raste, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton menjëherë KQZ-në, KZZ-në, si dhe zgjedhësit e QV-së mbi vendndodhjen e saj.

Neni 4
Kritere teknike

1. Vendndodhja e qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - a) të jetë me sipërfaqe minimumi 30 m²;
 - b) të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
 - c) të jetë mjedis me ndriçim të mjaftueshëm;
 - d) të jetë në katet e para të objekteve.
2. Të jetë i pajisur me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit.

Neni 5

1. KZZ-ja, në bashkëpunim me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore, marrin masa për:
 - a) pajisjen e QV-së me mjetet e nevojshme sipas skemës tip të planvendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - b) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara.
2. Vënien në dispozicion KQV-ve të mjediseve të caktuara për qenda votimi, jo më vonë se 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 6

Ngritja e qendrave të votimit në institucione të posaçme

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ngre, në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe akteve të KQZ-së, qendra votimi të posaçme në institucione të posaçme, kur kanë 15-100 votues, të cilët ndodhen brenda territorit të njësisë vendore që ai drejton.
2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton menjëherë KQZ-në dhe KZZ-në.

Neni 7

Dërgimi i numrit të QV-ve dhe numrit të zgjedhësve në listën përfundimtare

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, menjëherë me miratimin e listës përfundimtare dhe jo më vonë se 3 ditë nga shpallja e listës përfundimtare të zgjedhësve, dërgon në KQZ numrin e zgjedhësve në listë për çdo qendër votimi.

Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

